


AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOPHYSICAL

U D H Ë Z I M

PËR

**PËRCAKTIMIN E GRUPEVE SPECIFIKE TË TË DHËNAVE ME VLERË TË MADHE
NË FUSHAT “GJEOPHYSICAL” DHE “MJEDISORE DHE VËZHGIMIT TË TOKËS”**

Miratohet:
Vilma Tomço
DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Nr. 560/3 Prot

Tiranë, më 28.05.2025

U D H Ë Z I M

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E GRUPEVE SPECIFIKE TË TË DHËNAVE ME VLERË TË
MADHE NË FUSHAT “GJEOHAPËSINORE” DHE “MJEDISORE DHE VËZHGIMIT
TË TOKËS”¹**

Në mbështetje të nenit 28 pika ç) të ligjit nr. 9000 datë 31.03.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, nenit 15 të ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 17/1 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”,

U D H Ë Z O J

I. Qëllimi i Udhëzimit

1.1 Ky udhëzim hartohet me qëllim përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat “Gjeohapësinore” dhe “Mjedisore dhe Vëzhgimit të Tokës”², lidhur me ato tema, për të cilat Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është autoritet publik përgjegjës sipas Direktivës INSPIRE dhe ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i përditësuar.

1.2 Ky udhëzim përcakton gjithashtu masat për publikimin dhe ripërdorimin e grupeve të të dhënave me vlerë të lartë, në veçanti kushtet e zbatueshme për ripërdorim dhe kërkesat minimale për shpërndarjen e të dhënave nëpërmjet ndërfaqeve të programimit të aplikacionit (“API”).

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian 2023/138/BE, të datës 21 dhjetor 2022, që përcakton një listë të grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe dhe masat për publikimin dhe ripërdorimin e tyre, numër Celex 32023R0138, Fletore Zyrtare nr. 19, datë 20.1.2023, f. 43–75.

² Në këtë udhëzim përdorimi i togfjalëshit “mjedisore dhe vëzhgimit të tokës”, i referohet përcaktimit të nenit 16, pika 1/b) e ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, por ASIG referuar nenit 11 dhe nenit 15, të ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është përgjegjës për administrimin dhe publikimin e të dhënave me vlerë të madhe “vëzhgimi i tokës”, sipas Aneksit 2, të këtij udhëzimi.

II. Baza Ligjore

2.1 Ky udhëzim hartohet nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në koordinim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me ligjin nr. 72/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar si dhe të përafëruar plotësisht me Direktivën 2007/2/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 mars 2007 *“Për ngritjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në Komunitetin Evropian (INSPIRE)”*, konkretisht nenin 15, pika 1: *“ASIG-u është institucioni përgjegjës për administrimin e të dhënave gjeohapësinoe të mbledhura, të përpunuara dhe të përditësuara nga autoritetet publike sipas nenit 12 të këtij ligji”*.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 17/1 të ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*, i cili ka përafëruar Direktivën (BE) 2019/1024 të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019, *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e dokumenteve të organeve të sektorit publik”*, konkretisht:

“Për çdo kategori të të dhënave me vlerë të madhe për ekonominë dhe shoqërinë nga organi/et publike përgjegjëse, në koordinim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përcaktohen grupet specifike të këtyre të dhënave.”

Në përputhje me nenin 26/1 të ligjit nr. 72/2012, të përditësuar: *“Të dhënat gjeohapësinoe, të vëna në dispozicion nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, sipas pikës 1, të nenit 23, të këtij ligji, që përfshihen në listën e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe, sipas legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, ofrohen pa pagesë nga ASIG.”*

Si dhe, në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 02, datë 06.02.2025 *“Për miratimin e licencës Standarde të Ripërdorimit të Informacionit Publik”*.

III. Përkufizime

3.1 Për qëllimet e këtij udhëzimi do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- i. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 72/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”*;
- ii. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 6, të ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*;
- iii. *“atribut kyç”* nënkupton një karakteristikë të një objekti ose një entiteti në një grup të dhënash, siç është një kod ose emër kombëtar identifikimi;

- iv. "rezolucion" do të thotë niveli i detajeve të grupit të të dhënave;
- v. "shkarkim në masë" nënkupton një funksion që mundëson shkarkimin e një grupi të dhënash të tërë në një ose disa paketa.

IV. Fusha e aplikimit, procedurat dhe parimet e aplikueshme

4.1 Grupet e të dhënave me vlerë të madhe, për kategoritë "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore dhe Vëzhgimit të Tokës", janë të dhënat e përcaktuara sipas temave të Direktivës INSPIRE, miratuar nga Këshilli i Ministrave përmes standardeve shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, sipas Aneksit I dhe Aneksit II, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

4.2 Publikimi i të dhënave me vlerë të madhe për kategorinë "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore dhe Vëzhgimit të Tokës", për temat e Direktivës INSPIRE, të përcaktuara edhe në nenin 11, të ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet si më poshtë vijon:

- a) ASIG siguron për grupet e të dhënave me vlerë të madhe, të përcaktuara në Aneksin I dhe Aneksin II, kur ato janë të ruajtura në një bazë të të dhënave shtetërore, të vihen në dispozicion në format të lexueshëm nga pajisje kompjuterike nëpërmjet API-ve, që plotësojnë nevojat e ardhshme për ripërdorim;
- b) ASIG siguron që grupet e të dhënave me vlerë të madhe të vihen në dispozicion në formën e një shkarkimi të vetëm voluminoz (*bulk download*), kur të dhënat nuk ruhen në baza të të dhënave shtetërore;
- c) Kushtet e përdorimit të jenë të disponueshme në një format të lexueshëm nga njeriu dhe nga kompjuteri, që, bashkë me kriteret e cilësisë së shërbimit, të jenë në përputhje me marrëveshjet për ripërdorimin e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe për kategoritë përcaktuara në pikën 3.2;
- d) Kushtet e përdorimit të API-së shoqërohen me dokumentacionin e duhur në një format të hapur, të lexueshëm nga njeriu dhe kompjuteri, sipas standardeve të njohura;
- e) ASIG cakton një pikë kontakti për çështjet që lidhen me API-në, për të siguruar disponueshmërinë dhe mirëmbajtjen e API-së dhe publikimin efektiv të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe për kategoritë e përcaktuara në pikën 3.2;
- f) ASIG siguron që grupet e të dhënave të klasifikohen si grupe të dhënash me vlerë të madhe, në përshkrimin përkatës të metadatave.

4.3 Ripërdorimi i grupeve të të dhënave me vlerë të madhe për kategorinë "Gjeohapësinore" dhe "Mjedisore dhe Vëzhgimit të Tokës", për temat e Direktivës INSPIRE, kryhet si më poshtë vijon:

- a) çdo përjashtim, në përputhje me pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 33/2022, "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", publikohet online në faqen e internetit të ASIG dhe, për aq sa është e mundur, në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit

10, të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;

- b) për të lehtësuar disponueshmërinë e grupeve të të dhënave për ripërdorim, që mbulojnë periudha më të gjata kohore, detyrimet e vendosura sipas këtij udhëzimi do të zbatohen, gjithashtu, për grupet ekzistuese të të dhënave me vlerë të madhe të lexueshme nga kompjuteri, të krijuara përpara datës së zbatimit të këtij udhëzimi;
- c) grupet e të dhënave me vlerë të madhe për kategorinë “Gjeohapësinore” dhe “Mjedisore dhe Vëzhgimit të të Tokës” vihen në dispozicion për ripërdorim sipas kushteve të licencës përkatëse për të drejtën e ripërdorimit të miratuar në zbatim të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe Udhëzimit nr. 02, datë 06.02.2025 “Për miratimin e licencës Standarde të Ripërdorimit të Informacionit Publik”;
- d) grupet e të dhënave me vlerë të madhe, “Gjeohapësinore” dhe “Mjedisore dhe Vëzhgimit të të Tokës”, sipas Aneksit I dhe Aneksit II, vihen në dispozicion, në përputhje me rregullat për publikimin e ripërdorimin, sipas ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, dhe përcaktimeve të këtij udhëzimi.

4.4 Publikimi i grupeve të të dhënave me vlerë të madhe për kategorinë “Gjeohapësinore”, të përcaktuara në Aneksin I të këtij udhëzimi, dhe bërja e disponueshme e tyre për ripërdorim, kryhet si më poshtë vijon:

- a) Sipas kushteve të licencës *Creative Commons* 4.0 ose ndonjë licence tjetër ekuivalente ose me kushte më pak kufizuese të hapur;
- b) Në një format të hapur, të lexueshëm nga kompjuteri, të njohur ndërkombëtarisht;
- c) Të ofruara përmes programeve APIs dhe kur janë me rëndësi, të ofruara si një shkarkim i vetëm;
- d) Në versionin e tyre më të përditësuar;
- e) Metadata, që përshkruajnë grupet e të dhënave, për temat, pjesë e kategorisë “Gjeohapësinore”, janë në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë””.
- f) Niveli i detajimit të të dhënave, mbulimi gjeografik dhe atributet kryesore të grupeve të të dhënave me vlerë madhe, të përcaktuara në Aneksin I, janë në përputhje me standardet shtetërore, miratuar nga Këshilli i Ministrave për temat përkatëse.

4.5 Publikimi i grupeve të të dhënave me vlerë të madhe për kategorinë “Mjedisore dhe Vëzhgimit të të Tokës”, për temat e Direktivës INSPIRE dhe përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të përcaktuara në Aneksin II të këtij udhëzimi, dhe bërja e disponueshme e tyre për ripërdorim, kryhet si më poshtë vijon:

- a) Sipas kushteve të licencës *Creative Commons* 4.0 ose ndonjë licence tjetër ekuivalente ose me kushte më pak kufizuese të hapur;
- b) Në një format të hapur, të lexueshëm nga kompjuteri, të njohur ndërkombëtarisht;

- c) Përmes API-s dhe shkarkimeve të vetme voluminoze *bulk download*, (për versionet historike të grupeve të të dhënave: APIs ose shkarkimet voluminoze, sipas mundësive dhe përshtatshmërisë);
- d) Metadatat, që përshkruajnë grupet e të dhënave, për temat pjesë e kategorisë “*Mjedisore dhe Vëzhgimit të Tokës*”, sipas Direktivës INSPIRE, janë në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015 “*Për miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë*”;
- e) Grupet e të dhënave me vlerë të madhe përshkruhen në një dokumentacion të plotë dhe publikisht të disponueshëm *online*, që përfshin të paktën strukturën dhe semantikën e të dhënave;
- f) Grupet e të dhënave me vlerë të madhe përdorin fjalor dhe taksonomi të njohur ndërkombëtarisht dhe janë të dokumentuara publikisht, kur janë të disponueshme.

V. Masat mbi Implementimin e Udhëzimit

- a. ASIG, aktualisht, diktuar nga infrastruktura ekzistuese e institucionit (*Gjeoportali Kombëtar*), ofron të dhëna përmes shërbimeve ATOM, të disponueshme në [linku-n https://geoport.al/sq/dhenat](https://geoport.al/sq/dhenat). Shërbimet e imazherive (Ortofoto, Imazheri Satelitore, Harta Topografike etj) janë të hapura nëpërmjet shërbimeve WMTS.
- b. Në kuadër të bashkëpunimit me institucionin përgjegjës për implementimin e portalit *Open Data* dhe autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor sipas temave përkatëse të INSPIRE, pjesë e të dhënave me vlerë të madhe, parashikimet e këtij udhëzimi do të implementohen në varësi të rrethanave objektive dhe nivelit të bashkëpunimit me këto institucione.
- c. ASIG, lidhur me të dhënat sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, paraqet periodikisht (minimum 1 herë në vit), informacionin e nevojshëm pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbi ecurinë e zbatimit të këtij udhëzimi.
- d. ASIG dhe autoritete publike përgjegjëse për mbledhjen e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe sipas këtij udhëzimi, marrin masa për zbatimin e këtij udhëzimi.

VI. Dispozita të fundit

6.1 Këtij udhëzimi i bashkëlidhen Aneksi I dhe II, të cilat janë pjesë përbërëse e tij.

6.2 Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



ANEKSI I

KATEGORIA “GJEOHAPËSINORE”

Temat e përcaktuara sipas ligjit Nr. 72/2012, neni 11 (i përditësuar) (Aneksi I i Direktivës INSPIRE)	Specifikimet teknike për çdo temë të gjeoinformacionit janë të miratuara sipas VKM-ve përkatëse;
Kufijtë e njësive administrative	Tema – Kufijtë e njësive administrative. Miratuar me VKM-në nr. 1078, datë 23.12.2015.
Emërtimet Gjeografike	Tema: Emërtimet gjeografike. Miratuar me VKM nr. 142, datë 22.02.2017.
Sistemi i adresave	Tema: Sistemi i adresave. Miratuar me VKM-në nr. 859, datë 7.12.2016.
Ndërtesat	Tema: Ndërtesat. Miratuar me VKM-në nr. 359, datë 11.05.2016
Parcelat kadastrale	Tema: Parcelat kadastrale. Miratuar me VKM-në nr. 321, datë 27.04.2016.
Parcela Bujqësore	Tema: Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura. Miratuar me VKM-në nr.390, datë 09.06.2022. Tema: Përdorimi i tokës. Miratuar me VKM- në nr. 811 datë 21.10.2020.
Parcela Referente	Tema: Parcelat kadastrale. Miratuar me VKM-në nr. 321, datë 27.04.2016. Tema: Përdorimi i tokës. Miratuar me VKM- në nr. 811 datë 21.10.2020. Tema: Mbulesa e tokës. Miratuar me VKM- në nr. 809 datë 21.10.2020.

ANEKSI II

KATEGORIA “*MJEDISORE DHE VËZHGIMIT TË TOKËS*”, për temat e Direktivës INSPIRE

Temat e përcaktuara sipas ligjit Nr. 72/2012, neni 11 (i përditësuar) (Aneksi I-III i Direktivës INSPIRE)	Specifikimet teknike për çdo temë të gjeoinformacionit janë të miratuara sipas VKM-ve përkatëse;
Hidrografia	Tema: Hidrografia. Miratuar VKM-në nr. 829, datë 7.10.2015.
Zonat e Mbrojtura	Tema: Zonat e mbrojtura. Miratuar me VKM- në nr. 891 datë 18.11.2020.
Modeli Dixhital i Terrenit	Tema: Modeli dixhital i terrenit- Miratuar me VKM-në nr. 398, datë 19.06.2019.
Gjeologjia	Tema: Gjeologjia. Miratuar me VKM-në nr. 134, datë 20.03.2019.
Mbulesa e Tokës	Tema: Mbulesa e tokës. Miratuar me VKM- në nr. 809 datë 21.10.2020.
Ortoimazheria	Tema: Ortoimazheria. Miratuar me VKM-në nr. 397, datë 19.06.2019.
Zonat me përdorim të kufizuar	Tema: Zonat me përdorim të kufizuar. Miratuar me VKM-në nr.382, datë 29.06.2023.
Zonat Ekologjike	Tema: Zonat ekologjike. Miratuar me VKM-në nr.571, datë 11.10.2023.
Burimet Energjetike	Tema: Burimet energjetike. Miratuar me VKM- në nr. 950 datë 02.12.2020.
Infrastruktura për monitorimin e mjedisit	Tema: Infrastruktura për monitorimin e mjedisit. Miratuar me VKM-në nr. 210, datë 13.04.2023.
Habitatet	Tema: Habitatet. Miratuar me VKM-në nr. 211, datë 13.04.2023.

Përdorimi i Tokës	Tema: Përdorimi i tokës. Miratuar me VKM- në nr. 811 datë 21.10.2020.
Burimet minerare	Tema: Burimet minerare. Miratuar me VKM-në nr. 997, datë 9.12.2020.
Zonat me rreziqe natyrore	Tema: Zonat me rreziqe natyrore. Miratuar me VKM- në nr. 810 datë 21.10.2020.
Infrastruktura Industriale	Tema: Infrastruktura Industriale. Miratuar me VKM-në nr. 212, datë 13.04.2023.
Detet	Tema: Detet. Miratuar me VKM-në nr.1018, datë 16.12.2020.
Pedologjia	Tema: Pedologjia. Miratuar me VKM- në nr. 951 datë 02.12.2020.
Shpërndarja e specieve	Tema: Shpërndarja e specieve. Miratuar me VKM-në nr.572, datë 11.10.2023.